



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR VITIN 2020

Prishtinë, korrik 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkohet falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: z.Mytaher Haskuka , Kryetari i Komunës
Adresa: Remzi Ademaj , Prizren, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Prizrenit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prizrenit (KPZ), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Prizrenit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Komunës së Prizrenit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Prizrenit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Komuna gjatë viteve 2016-2020 ka fshirë/anuluar borxhet në vlerë 364,284€ ndaj 2,397 amvisërive bazuar në kërkesa verbale pa formuar komision për shqyrtimin e ankesave.
- B1 Komuna gjatë vitit 2020 kishte kryer pagesa në vlerë prej 5,898,000€ apo 2,859 raste të pagesave të cilat e kanë tejkaluar afatin ligjor si dhe pagesa shtesë për procedura përmbartimore në vlerë 106,965€.
- B2 Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në prone
- B3 Komuna ka faturuar dhe arkëtuar tarifën për mbeturina në shumë prej 12€/për vit pa ndonjë bazë ligjore (vendim të Kuvendit Komunal), përderisa ngarkesa e tarifës vjetore duhet të ishte 54€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Theksimi i Çështjes

- 1 Gjatë vitit 2020 Komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 495,813€ në kategori ekonomike jo adekuate, si në vijim:

Si rezultat i planifikimit jo adekuat të buxhetit nga kategoria e investimeve kapitale komuna kishte paguar 300,711€, prej tyre 162,378€ ishin për shpenzime të cilat i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve si dhe 138,333€ për shpenzime të cilat i takojnë kategorisë subvencione dhe transfere; si dhe

Nga kategoria mallra dhe shërbime kishte paguar 195,102€, prej tyre 106,624€ ishin shpenzime për paga dhe mëditje si dhe 88,478€ për subvencione dhe transfere.

Duke qenë se çështja në fjalë është mjaft e përhapur në shumë organizata buxhetore dhe po përsëritet për vite me radhë, ajo do të trajtohet më hollësisht në Raportin e auditimit të Pasqyrave Financiare të Qeverisë, ku edhe do të jepen rekomandimet përkatëse për zgjidhje afatgjatë.

Opinioni i auditimit nuk është modifikuar për shkak të kësaj çështje

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara,

qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Prizrenit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Prizrenit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Prizrenit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Prizrenit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar

procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Prizrenit.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur në Grafikon 1, më poshtë) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike⁴



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 4].

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Parregullsi gjatë fshirjes/anulimit të borxheve për mbeturina

Gjetja

Neni 3 paragrafi 3.5 i Rregullores “Mbi Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Prizrenit” e aprovuar me dt. 19.09.2013 përcakton që duhet bëhet: Formimi i komisionit në kuadër të administratës komunale, për shqyrtimin e ankesave dhe parashtresave të taksapaguesve për mbeturina.

Bazuar në të dhënat e ofruara nga komuna kemi vërejtur se gjatë viteve 2016-2020 nga regjistri i llogarive të arkëtueshme për mbeturina Komuna kishte fshirë/ anuluar borxhet në vlerë 364,284€ ndaj 2,397 amvisërive me arsyetimin se gabimisht kishte faturuar me nga dy fatura për të njëjtin amvisëri.

Komuna nuk kishte formuar komision i cili do të shqyrtonte ankesat e qytetarëve dhe dëshmitë përkatëse për të verifikuar nëse faturimi ka qenë i gabuar. Po ashtu, nuk kishte asnjë ankesë nga qytetarë në formë të shkruar (protokolluar). Shlyerja e borxheve ishte bërë direkt në softuer nga zyrtarët komunal bazuar në ankesat verbale të qytetarëve. Komuna përdorë një program softuerik për menaxhim e Llogarive të arkëtueshme për mbeturina, mirëpo ky program nuk ofron siguri të mjaftueshme pasi që sipas zyrtarëve komunal nuk mbeten gjurmë nga shlyerja e borxheve dhe ndryshimet tjera.

Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së kontrollit të brendshëm efektiv me rastin e shlyerjes së borxheve.

Ndikimi

Fshirja e borxheve në mungesë të ankesave të protokolluara si dhe mos formimi i komisionit për shqyrtimin e tyre rrit rrezikun e shlyerjes së borxheve në mungesë të dëshmive përkatëse, po ashtu, ndikon edhe në trajtimin jo të barabartë të taksapaguesve. Më tutje, intervenimi në softuerin për mbeturina duke anuluar faturat pa ndonjë gjurmë në sistem, lë hapësirë për keqpërdorim si dhe shkakton pasiguri të saktësisë së llogarive të arkëtueshmeve.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të formojë një komision profesional i cili do të verifikoj faturat e fshira/anuluara për tu siguruar se faturat e fshira/anuluara vërtet kanë qenë gabim bazuar në gjendjen faktike. Po ashtu, duhet të sigurojë se ankesat pranohen përmes zyrës së protokollit dhe se shqyrtimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Vonesa në pagesën e faturave dhe shpenzimet shtesë të procedurave përmbartimore**Gjetja**

Sipas nenit 39.1 të ligjit Nr.03/L-048 për MFPP, Çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës. Ndërsa, sipas nenit 40, fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhrit të prerë nga gjykata/përmbartuesi.

Nga analiza e data bazës së furnitorëve kemi vërejtur se komuna gjatë vitit 2020 kishte kryer pagesa në vlerë prej 5,898,000€ apo 2,859 raste të pagesave të cilat e kanë tejkaluar afatin ligjor. Vonesat variojnë nga 1 muaj deri në 4 vite.

Po ashtu vlera e 10 pagesave të realizuara nga Thesari në bazë të vendime gjyqësore/përmbartimore ishte 1,647,602€, prej tyre borxhi kryesor ishte 1,540,637€ ndërsa 106,965€ ishin shpenzime të interesit dhe procedurale të gjykatës/përmbartimit.

Hyrja në obligime pa buxhet dhe neglizhenca e zyrtarëve përgjegjës ka ndikuar në mos realizimin e pagesave brenda afatit kohorë ligjor dhe njëherit realizimin e pagesave me vendime gjyqësore/përmbartimore.

Ndikimi

Si pasojë e vonesave të pagesave dhe mungesës së informacioneve të plota, mund të dobësohet aftësia e komunës për të parashikuar dhe menaxhuar nevojat për likuiditet. Po ashtu, komuna mund të jetë subjekt i padive nga operatorët ekonomik, duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/ përmbartimore.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të sigurojë që obligimet të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i komunës me kosto shtesë të përmbartimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B2 - Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë****Gjetja**

Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 11 pika 1 definon:” Zbritja për vendbanimin parësor- Personi fizik, i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit, para vitit tatimor se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaron këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit, i lejohet zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit.

Po ashtu, Ministria e Financave përkatësisht Departamenti i Tatimit në Pronë ka njoftuar komunat për vendimin e marr për regjistrimin e numrit personal në rastin e zbatimit të nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-005, kjo me qëllim të shmangies së duplikimeve/apo parregullsive dhe sigurimin e zbatimit efektiv të këtij neni. Për më tepër, regjistrimi i numrave personal rrit efikasitetin, garanton informata më të sakta dhe të besueshme në regjistrin e tatimit në pronë dhe sjell përfitime të tjera të shumta për tatimpaguesit. Lidhur me këtë kemi identifikuar mangësitë në vijim:

- Në pesë raste nga mostrat e testuara, tatimpaguesit që nuk posedonin prona të regjistruara për vendbanim parësor, komuna ju kishte lejuar zbritjen prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e pronës. Po ashtu, nga analiza e data bazës për tatimin në pronë të siguruar nga komuna, kemi vërejtur se zbritja ishte aplikuar tek 1,050 prona të cilat nuk ishin të regjistruara si vendbanim parësor. Si rezultat i kësaj komuna ka ngarkesa tatimore vjetore më të ulëta në vlerë të përafërt prej 23,625€.

Mungesa e stafit mbështetës ka ndikuar që gabimet të mos përcjellën tek zyrtarët e nivelit qendror për korrigjimet e nevojshme.

- Në pesë raste nga mostrat e testuara ishte aplikuar zbritja për pronat personave që nuk kishin të evidentuar numrin personal. Po ashtu, nga analiza e data bazës për tatimin në pronë të siguruar nga komuna, kemi vërejtur se 15,384 personave iu ishte bërë zbritja pa numër personal ku për pasojë rezulton afër 369,216€ më pak të hyra nga kjo kategori.

Zyrtarët komunal theksuan se kanë marrë përgjigje nga departamenti i tatimit në pronë në MF se “Ky problem do të vazhdojë të ekzistojë deri sa të plotësohet numri personal për të gjithë tatimpaguesit” dhe tek në vitin 2021 zbritja nuk do të aplikohet për këto raste.

Ndikimi

Vlerësimi i njësive rezidenciale me zbritje pa numër personal, dhe pa deklaram se vendbanimi i tatimpaguesit shërben si vendbanim parësor, mund të rezultojë me kalkulim të parregullt të zbritjes apo shmangie nga tatimi në pronë, ku për pasojë komuna pranon më pak të hyra nga kjo kategori.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të siguroj bashkëpunim dhe komunikim më të mirë në mes të Departamentit të Tatimit në Pronë Komunal dhe Ministrisë së Financave, në mënyrë që të eliminohen gabimet e mundshme në bazën për tatimin e vlerësuar, apo ndonjë gabimi tjetër eventual.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Dobësi në menaxhimin e të hyrave nga sektori i mbeturinave

Gjetja

Sipas Rregullores “Mbi Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Prizrenit”, neni 3 Përgjegjësia e Komunës mbi Menaxhimin e Mbeturinave: pika 3.1 Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm mbi menaxhimin e mbeturinave të ngurta komunale, dhe neni 5 Taksa mbi mbeturinat pika 5.1 Taksa mbi mbeturinat, nga janari i vitit 2014, do të faturohet dhe inkasohet nga Komuna. Në shtojcën 1, të kësaj rregullore përcaktohet tarifa e taksës për mbeturina ku për amvisëritë në zonën urbane dhe rurale është në shumë prej 4.50€ për muaj ose 54€ për vit.

Në bazë të të dhënave të cilat posedojmë, në sistemin e menaxhimit të mbeturinave numri i qytetarëve që jetojnë jashtë vendit është 2,002 amvisëri në këtë shifër nuk përfshihen edhe kryefamiljar tjerë të cilët nuk

janë lajmëruar që disa vite me radhë. Komuna ka faturuar dhe arkëtuar tarifën për mbeturina në shumë prej 12€/për vit pa ndonjë bazë ligjore (vendim të Kuvendit Komunal), përderisa ngarkesa e tarifës vjetore duhet të ishte 54€. Si rezultat i këtij nën faturimi komuna edhe këtë vit ka mbledhë më pak të hyra në vlerë prej 84,084€.

Shkaku për këtë është mungesa e veprimeve të komunës për plotësim/ndryshim të rregullores për menaxhimin e mbeturinave.

Ndikimi

Mos azhurnimi i të dhënave sipas gjendjes faktike në teren si dhe mos aplikimi i ngarkesave sipas kërkesave ligjore apo rregullores së aprovuar për grumbullimin e mbeturinave rrit rrezikun që të hyrat prej kësaj kategorie të jenë më të ulëta.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të sigurojë se do të kryhen analiza të mirëfillta nga menaxhimi i mbeturinave në mënyrë që të arrihen objektivat e komunës në krijimin e sistemit të qëndrueshëm financiar. Po ashtu, të merret në konsideratë që paraprakisht të rifreskohet data baza e ngarkesave si dhe të bëhen ndryshimet dhe aprovimet në rregullore nga organi legjislativ për lirim apo përcaktimin e tarifa për amvisëritë e caktuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Prizrenit në 2020 ishin në vlerë 5,971,583€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga grumbullimi i mbeturinave, taksat administrative, taksat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga lejet e ndërtimit etj. Në krahasim me vitin paraprak, të hyrat e realizuar në vitin 2020 ishin më të ulëta për 981,580€, dhe për këtë kishte ndikuar pandemia me virusin Covid 19. Përveç këtyre, komuna kishte inkasuar edhe të hyra indirekte të cilat mblidhen nga niveli qendror (gjobat në trafik, të gjykatave si dhe nga agjencia e pyjeve) në vlerë prej 930,143€ . Kemi testuar 33 mostra për teste substanciale në vlerë 20,849€ si dhe dhjetë mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B4 - Shfrytëzim i parregullte i pronave komunale

Gjetja

Ligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale 06/L-092”, neni 23 pika 1 cek: ”Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona i kthehet komunës”.

Komuna me dt.01.08.2001 ka bërë Marrëveshje mbi Koncesionin për tregjet “B. Curri “dhe “Qylhani” me kohëzgjatje për 10 vite, deri më dt. 01.08.2011, nga kjo datë kanë bërë Aneks kontratë për një periudhë dy vjeçare deri më 01.08.2013, duke u bazuar mbi kushtet e marrëveshjeve fillestare dhe duke cekur se kjo kontratë nuk mund të vazhdohet më tutje.

Që nga viti 2013 tregjet janë shfrytëzuar pa kontrata dhe komuna nuk ka ndërmarr asnjë hap për lirim të këtyre pronave (tregjeve). Nga Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave ishte vendosur që të ngarkohen me tarifë deri në vitin 2016. Komuna nga viti 2017 nuk i ka faturuar këta shfrytëzues të pronave, pasi që nuk ka bazë ligjore për ngarkesë, përderisa shfrytëzuesit privat brenda këtyre tregjeve, paguajnë qira për shfrytëzimin e tezgave apo lokaleve që gjinden në treg.

Shkak për këtë është mos implementimi me kohë i kushteve të kontratës me shfrytëzuesit e hapësirave dhe mos ndërmarrja e masave të nevojshme nga ana e komunës.

Po ashtu, nga viti 2016 tetë parti politike shfrytëzojnë pronat-lokalet komunale me çmim prej 1€ në muaj për lokal. Këto lokale ishin dhënë duke u bazuar në vendimin e asamblesë komunale të dt.29.12.2005.

Pas përfundimit të auditimit për vitin 2020 komuna me vendim të Kryetarit ka larguar nga pronat komunale të gjitha partitë politike.

Ndikimi

Shfrytëzimi i tregjeve dhe pronave tjera publike, pa kontrata valide mes komunës dhe shfrytëzuesve të pronës komunale, i shkakton komunës humbje të konsiderueshme financiare.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të siguroj marrjen e masave për largimin e shfrytëzuesëve ilegal nga pronat publike, arkëtimin e borxheve dhe më pastaj dhënia e pronës publike me qira të realizohet sipas Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale 06/L-092.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 20,695,556€. Numri i lejuar i stafit sipas buxhetit/planifikimit ishte 3,168 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 3,126. Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 83,566€, si dhe 12 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A2 - Mangësi në procesin e rekrutimit të stafit

Gjetja Sipas UA 07/2017 për Rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik neni 6 paragrafi 5.1 parasheh që - 'Konkursi publik duhet të përsëritet nëse se paku tre kandidatë nuk i plotësojnë kushtet e konkursit'.

Në dy raste (në drejtorin e Arsimit për mësimdhënëse të Pianos dhe të Harmonikës në shkollën "Lorenç Antoni") procedura e rekrutimit nuk ishte anuluar përkundër faktit që për pozitat e caktuara kishte vetëm nga një kandidat që kishte aplikuar në këto pozita.

Sipas zyrtarëve komunal konkursi nuk ishte anuluar me arsyetimin se edhe nëse do rishpallej nuk do të kishte interesim të kandidatëve për këto pozita.

Ndikimi Mungesa e konkurrencës së mjaftueshme e paraparë me dispozitat ligjore mund ndikojë në përzgjedhjen e stafit jo kompetent për pozitën e caktuar.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë përmes menaxherit të personelit se zhvillimi i procedurave të rekrutimit bëhet në pajtim të plotë me kërkesat ligjore, dhe në rast të mungesës së tre kandidatëve të përgjegjshëm të rishpallet konkursi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mos harmonizimi ndërmjet akt emërimit dhe koeficienteve për kompensimin e pagave

Gjetja Paguesa e stafit duhet të bëhet në bazë të koeficienteve të përcaktuar me akt emërim për pozitën e caktuar.

Megjithatë, ne kemi vërejtur se në katër raste kishte mos harmonizim ndërmjet koeficienteve dhe pozitive në akt emërimit dhe listën e pagave si:

- Zyrtari për buxhet dhe financa në drejtorin e arsimit sipas akt emërimit kishte koeficientin 6, ndërsa në listën e pagave paguhet si zyrtar i lartë për buxhet dhe financa me koeficient 8; dhe

- Në drejtorin e kadastrit tre (3) zyrtar sipas akt emërimit kishin pozitën gjeometër me koeficient 5, ndërsa në listën e pagave figuronin si gjeodet dhe paguhet me koeficientin 7.

Shkaku i kësaj dukurie ishte mosfunksionimi i kontrolleve te brendshme për të harmonizuar akt emërimet me listën e pagave sipas ndryshimeve aktuale.

Ndikimi Mos harmonizimi ndërmjet akt emërimeve dhe listës së pagave mund të rezultojë në kompensime të parregullta dhe njëherësh në dëmtim të buxhetit.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të siguroj që të gjithë të punësuarit paguhen në bazë të pozitave zyrtare që janë të emëruar dhe të sigurojë harmonizimin e akt emërimeve me listën e pagave për të gjithë të punësuarit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte 8,582,131€, prej tyre ishin shpenzuar 7,438,923€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzimet për mirëmbajtjen e hapësirave, shpenzime për derivate, furnizime mjekësore, shpenzime komunale, shpenzime tjera në kuadër të administratës komunale dhe arsimit. Kemi testuar 47 mostra për teste substanciale në vlerë 2,684,991€ si dhe 7 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A4 - Parregullsi gjatë aplikimit të procedurave të negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës

Gjetja Neni 35 paragrafi 2.1 (iii) i LPP nr.04L-042 përcakton që - 'Nëse, për aq sa është shumë e nevojshme për arsye të emergjencave ekstreme që janë shkaktuar nga ngjarje objektivist të verifikueshme të cilat nuk kanë pasur mundësi të parashikohen me arsye nga autoriteti përkatës kontraktues, autoriteti i tillë kontraktues nuk mund ta japë kohën e kërkuar për ushtrimin e cilësdo procedurë tjetër që parashtrohet në këtë ligj. Po ashtu, paragrafi 3 përcakton që -'Ekzekutimi i një procedure të negociuar pa publikimin e njoftimit të kontratës në asnjë mënyrë nuk e liron autoritetin kontraktues nga detyrimi i tij që (i) të luajë një rol aktiv në përcaktimin e kushteve të kontratës, veçanërisht sa ka të bëjë me çmimet, afatet e pranimit, sasitë, karakteristikat teknike dhe garancionet'.

Me dt.16.03.2020, KRPP-ja kishte njoftuar të gjitha autoritetet kontraktuese se, si rezultat i situatës së krijuar nga COVID-19 mund ti përdorin procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit për kontratë. Përderisa, njoftimi i KRPP-së nr. 47/2020 i dt. 12.06.2020 parasheh shfuqizimin e mundësisë së përdorimit të kësaj procedure për çështjen e pandemisë (vendimit paraprak).

Pas njoftimit të KRPP-së nr. 47/2020 i dt. 12.06.2020 i cili parasheh shfuqizimin e mundësisë së përdorimit të procedurës së cekur më lartë, komuna në tri⁵ raste kishte përdorur procedurën e negociuar pa publikim

të njoftimit për kontratë. Për me tepër në dy nga këto mostra përveç fituesit që ka pasur veprimtarinë përkatëse, komuna kishte ftuar edhe nga dy OE për negociata që nuk kishin veprimtarinë e duhur të procedurës tenderuese.

Ndërsa në një rast komuna kishte ftuar vetëm një OE për negociim me të cilin kishte lidhur kontratë. Si rezultat i përdorimit të kësaj forme të procedurës dhe mos ftesa e OE tjerë që janë profesional në ofrimin e shërbimit/furnizimeve ka ndikuar në kufizimin e konkurrencës në lidhje me çmimet dhe cilësinë e shërbimeve/furnizimeve të kontraktuara.

Sipas zyrtareve komunal kjo ka ndodhur si rezultat i kohës me pandemin Covid 19 dhe për këtë shkak janë konsideruar si procedura emergjente dhe kemi aplikuar këtë lloj të procedurës.

Ndikimi Përdorimi i procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë dhe mos ftesa e OE tjerë që janë profesional në ofrimin e shërbimeve/furnizimeve ndikon në kufizim të konkurrencës dhe njëherësh rrit rrezikun e kontraktimit të mallrave/shërbimeve me çmime dhe cilësi jo komfor kushteve të tregut.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të siguroj aplikimin e procedurave të duhura të prokurimit duke rritur konkurrencën në mënyrë që kontraktimi i mallrave/furnizimeve të bëhet me çmime dhe cilësi komfor kushteve të tregut.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 1,989,036€, prej tyre ishin shpenzuar 1,877,049€ apo 94% e buxhetit. Ato kanë të bëjnë kryesisht me subvencionimin e entiteteve publike dhe jo publike, pagesat për sektorin e blektorisë, pagesat për kulturat bujqësore, mbështetje financiare për rimëkëmbje ekonomike etj. Kemi testuar shtatë mostra për teste substanciale në vlerë 209,097€ si dhe tetë mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja C1 - Vlerësimi jo sipas kritereve të përcaktuara me thirrje publike

Gjetja Kriteret e vendosura në thirrjen publike të dt.13.10.2020 për subvencionim ishin: formulari, kopje letërnjoftimi, certifikata për regjistrim si OJQ, çertifikaten që nuk janë nën hetime, dëshmitë që nuk kane obligime ndaj ATK-së dhe konfirmimin nga banka e aplikuesit.

Komisioni për vlerësim të aplikacioneve për subvencionimin e OJQ-ve kishte shpërblyer dy OJQ (vlera e subvencioneve 142,000€) të cilat kishin obligime të pashlyera ndaj ATK-së.

Kjo ka ndodhur për shkak të funksionimit jo të mire të kontrolleve të brendshme.

Ndikimi Përzgjedhja e përfituesve pa i plotësuar kriteret e vendosura në shpalljen publike ka reflektuar në trajtim jo të barabartë të aplikuesve dhe se, komuna rrezikon financimin e përfituesve të papërgjegjshëm, përmes fondeve publike.

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të siguroj që ka transparencë në procedura dhe vendimmarrje në gjithë ciklin e ofrimit të mbështetjes financiare, duke përfshirë publikimin e kriterëve dhe procedurave, aplikimin, vendimmarrjen dhe përzgjedhjen e përfituesve. Çdo ofrues i mbështetjes financiare (komuna) që planifikon mbështetje financiare për OJQ-të duhet të disponojnë me kapacitete institucionale, duke përfshirë burimet e nevojshme njerëzore për të zbatuar kërkesat ligjore. Komisioni Vlerësues të përbëhet nga anëtarë që kanë përvojë dhe integritet, me mandat për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve, në të kundërtën duhet të zbatohet parimi i llogaridhënies për shfrytëzimin e këtyre fondeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 21,451,701€, prej tyre ishin shpenzuar 14,387,609€. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e rrugëve lokale, mirëmbajtjen investive, objektet arsimore, pajisje tjera etj. Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 4,062,122€ si dhe shtatë mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B5 - Mungesa e projektit ekzekutiv

Gjetja Neni 20 pika 10 i Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (UOPP) kërkon që specifikat teknike për kontratën e punës, duhet të përfshijnë një projekt ekzekutues si pjesë substanciale të veten". Ndërsa, pika 13 "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet ti bashkëngjitet specifikave teknike të cilat janë pjesë e dosjes së tenderit". Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.

Në kontratën "Rregullimi i shtigjeve për biçikletë Downhill" në vlerë prej 8,830€ e nënshkruar më dt.21.09.2020, komuna nuk e kishte hartuar projektin ekzekutiv, por kishte iniciuar procedurat e prokurimit duke përgatitur vetëm para masën dhe paralogaritë.

Shkaqet e mos hartimit të projektit ishin neglizhenca e zyrtarëve përkatës dhe fakti që procedurat e prokurimit të mos vonohen

Ndikimi Zhvillimi i procedurave të prokurimit pa një projekt të hartuar paraprakisht mund të ndikoj që punimet e zbatuara në këtë projekt të devijojnë nga kërkesat standarde të ndërtimit dhe të mos arrijnë cilësinë e duhur.

Rekomandimi B5 Kryetari duhet të sigurojë që hartimi i projekteve ekzekutive të realizohet në pajtim me kërkesat ligjore, gjegjësisht hartimin e tyre para inicimit të procedurave të prokurimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B6 - Zotimi i mjeteve pas faturës**

Gjetja Sipas rregullës financiare Nr. 01/2013 për shpenzimin e parasë publike “Asnjë kontratë publike nuk duhet të nënshkruhet pa zotim të mjeteve” gjithashtu “Organizata buxhetore nuk ndërmerr asnjë obligim gjatë vitit aktual fiskal në një shumë që i tejkalon fondet e ndara”.

Në tetë raste komuna kishte pranuar faturën së bashku me dokumentacionin mbështetës para datës së kërkesës për zotim të mjeteve dhe kërkesës për mallra dhe shërbime. Vlera e faturave të pranuar është 529,391€.

Kjo praktike është përsëritur vit pas viti për shkak të mungesës së funksionimit të kontroleve të brendshme.

Ndikimi Hyrja në obligime pa fonde të zotuar rezulton në pamundësinë e financimit në tërësi të këtyre projekteve. Kjo mund të rezultojë me dështim të realizimit të tyre.

Rekomandimi B6 Kryetari duhet të siguroj që para nënshkrimit të kontratave të bëhet zotimi i mjeteve në mënyrë që të eliminohet praktika e pranimit të mallit dhe punëve pa zotim të mjeteve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B7 - Mos - vazhdimi i sigurisë së ekzekutimit komfor periudhës së zbatimit të kontratës**

Gjetja Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimit Publik, neni 30 përcakton: “Siguria e ekzekutimit është paraparë të mbështetë përmbushjen e kontratës. Shuma e sigurimit të ekzekutimit do të jetë e barabartë me të paktën 10% të vlerës së kontratës. Sigurimi i ekzekutimit do të mbetet valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas kompletimit të kontratës”. Po të njëjtin obligim ligjor komuna e kishte përfshirë edhe te kushtet e veçanta të kontratave, për punë (në nenin 1.18).

Në dy raste ⁷, komuna përkatësisht zyra e prokurimit nuk kishte kërkuar vazhdimin e sigurimit të ekzekutimit të kontratës, krahas shtyrjes së periudhës së ekzekutimit apo periudhës sa kontrata ishte aktive.

Shkaku i një dukurie të tillë ishin vonesat në realizimin e kontratave dhe neglizhenca e zyrtarëve përkatës për të ripërtërirë sigurimin e ekzekutimit për kontratat përkatëse, përkatësisht mungesa e komunikimit në mes të menaxherëve të kontratave dhe Zyrës së Prokurimit.

Ndikimi Mungesa e sigurisë së ekzekutimit përveç që është anashkalim ligjor, rrit rrezikun që autoriteti kontraktues të mos ketë mbulesë për dëmet dhe shpenzimet eventuale të mundshme që mund të rrjedhin gjatë periudhës së shtyrë për implementimin e këtyre kontratave.

Rekomandimi B7 Kryetari duhet të siguroj përmes zyrtarëve përgjegjës, që çdo projekt të realizohet brenda kornizës kohore të përcaktuar në kontrata dhe se sigurimi i ekzekutimit duhet të ketë vlefshmëri në raport me periudhën e përmbushjes së kontratës ashtu siç parashihet në ligj.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B8 - Vonesa në realizimin e kontratave

Gjetja Sipas Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik, pikat 61.6, 61.19 dhe 61.20 përcaktojnë se: “Menaxherët e kontratës janë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe duhet të sigurojnë se OE kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë. Secila kontratë publike ka të përcaktuar afatin kohor të implementimit.

Në dy ^a raste komuna nuk kishte realizuar punimet sipas planit dinamik siç parashihej me kontratë, deri sa ishim në auditim (mars 2021) asnjëra nga këto projekte nuk i kishte përfunduar punimet. Vonesa ishte deri në një vit.

Shkak i vonesave ishte mungesa e mjeteve në dispozicion për të përfunduar kontratën si pasojë e planifikimit jo të duhur të projektit dhe të disa ndryshimeve në pozicione gjatë realizimit.

Ndikimi Vonesat në realizimin e kontratave rrisin rrezikun që obligimet kontraktuale të barten për tu paguar në vitet e ardhshme, të cilat do të jenë barrë për buxhetin e viteve në vijim.

Rekomandimi B8 Kryetari duhet të siguroj që paraprakisht të eliminohen shkaqet e vonesave, të sigurohen fondet e nevojshme, planifikimi i mirëfilltë si dhe të forcohen kontrollet në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve në mënyrë që ato të përfundohen me kohë sipas planit dinamik. Aty ku është e nevojshme, të zbatohen masat ndëshkuese sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.6 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 489,424,724€, pasurive jokapitale është 1,728,162€ si dhe e stoqeve 176,193€. Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 2,625,678€.

Çështja B9 - Mangësi në menaxhimin e pasurisë

Gjetja Neni 6 paragrafi 3 i Rreg. nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare përcakton që: “Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-

pasuria.” Më tutje neni 19, pika 4.7, përcakton se inventarizimi i pasurisë duhet të kryhet para përfundimit të PFV-ve. Po ashtu sipas nenit 20 “Organizata buxhetore duhet të bëjë vlerësimin e pasurisë jo financiar për të vërtetuar nevojshmërinë e pasurisë jo financiare për organizatën, gjendjen fizike dhe mundësinë për ta përdorur në njësitë tjera të organizatës”.

Lidhur me këtë kemi identifikuar se:

- Regjistri i e-pasurisë nuk është i plotë për arsye se blerjet nga sektori i QKMF-së, Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Arsimit nuk regjistrohen në këtë softuer por se mbahen në regjistra të brendshëm në Excel;
- Komisioni i inventarizimit të pasurisë ishte formuar me kohë, mirëpo nuk kishte arritur të përfundoj raportin para përgatitjes së PFV. Raporti për inventarizimin e pasurisë së komunës është përfunduar me 24.02.2020. Rrjedhimisht, asnjë rezultat i inventarizimit nuk është reflektuar në PFV dhe
- Përkundër faktit që komisioni i inventarizimit kishte identifikuar pasuri të dëmtuar dhe një pjesë e pasurisë figuron me vlerën zero në regjistër të pasurisë, komisioni për vlerësimin e pasurisë nuk ka bërë vlerësimin e pasurisë jashtë përdorimit dhe atyre me vlerë zero.

Kjo ka ndodhur për shkak të neglizhencës së zyrtarëve përgjegjës për realizimin e detyrave të përcaktuara me kohë dhe sipas legjislacionit përkatës.

Ndikimi

Mos kryerja e procesit të inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë brenda afatit të paraparë ligjor, si dhe mos funksionimi i plotë i sistemit e-pasuria rrit rrezikun për informata të mangëta mbi gjendjen e pasurisë. Njëherit, rrit rrezikun e keqpërdorimit dhe keq menaxhimit të tyre si dhe ndikon në prezantim jo të drejtë të gjendjes së tyre në PFV.

Rekomandimi B9

Kryetari duhet të siguroj që kërkesat në lidhje me regjistrimin dhe mirëmbajtjen e pasurive duhet të aplikohen në tërësi, ku përmes sistemit e-pasuria evidentohen të gjitha hyrjet/daljet e pasurive të luajtshme nën 1,000€ për të gjitha dikasteret komunale. Po ashtu, duhet të siguroj që raportet e komisionit të inventarizimit dhe ai i vlerësimit të harmonizohen me gjendjen e pasurisë në regjistra dhe i paraprijnë përgatitjes së PFV, në mënyrë që vlera e pasurisë të prezantohet saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.7 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2020, ishte 2,528,654€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2021.

Çështja B10 - Prezantimi jo i plotë i detyrimeve kontingjente

Gjetja

Neni 18 i Raportit Vjetor Financiar për Organizatat Buxhetore parasheh prezantimin e detyrimeve kontingjente dhe shpalosjen në detaje të shënimeve në tabelë.

Bazuar në dëshmitë e ofruara nga komuna vlera e detyrimeve kontingjente në fund të vitit 2020 duhet të ishte se paku prej 11,028,167€, për derisa komuna në PFV kishte shpalosur vetëm 2,428,139€ detyrime kontingjente. Po ashtu, tri pagesa të realizuar në vitin 2020 në vlerë 570,050€ ishin shpalosur si detyrime kontingjente.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos koordinimit ndërmjet departamentit ligjor dhe departamentit të financave.

Ndikimi

Mos prezantimi i plotë i detyrimeve kontingjente (pasive gjyqësore) shkakton nënvlerësim të tyre dhe për pasoj mos planifikimin e duhur të buxhetit për mbulimin e detyrimeve financiare në vitin pasues në rast të humbjes së këtyre kontesteve.

Rekomandimi B10

Kryetari duhet të siguroj që detyrimet kontingjente janë prezantuar drejtë në PFV. Duhet të sigurohen të dhënat e sakta dhe të plota mbi këto detyrime nga zyra ligjore dhe të njëjtat të përcillen në zyrën e financave si hartuese të PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

“Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁹	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	50,901,461.00	53,654,638.00	44,966,503.53	42,816,371.46	41,749,764.99
Grante Qeveritare – Buxheti	43,341,166.00	41,512,487.56	37,528,619.71	34,815,742.67	33,736,652.87
Financimi përmes huamarrjes	0.00	577,269.40	526,541.64	66,165.14	156,008.42
Të bartura nga viti i kaluar	0.00	3,125,319.86	2,514,547.79	2,389,111.74	2,996,202.81
Të hyrat vetanake	7,560,295.00	7,560,295.00	4,199,009.70	5,203,033.92	4,687,468.61
Donacionet vendore	0.00	652,627.59	132,793.13	121,279.37	56,121.00
Donacionet e jashtme	0.00	226,638.59	64,991.56	221,038.62	117,311.28

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 2,753,177€, kjo rritje është rezultat i kursimeve nga granti qeveritar në bazë të vendimit të qeverisë për 1,828,678€, bartjes së të hyrave nga viti paraprak 3,125,320€, rritjes së fondeve nga huamarrja 577,269€ dhe përfitimi i fondeve nga donatorët e brendshme 652,628€ dhe të jashtëm për 226,639€. Në vitin 2020 Komuna ka shpenzuar 84% të buxhetit përfundimtar, me një përmirësim 5% në krahasim me vitin 2019.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	50,901,461.00	53,654,638.00	44,966,503.53	42,816,371.46	41,749,764.99
Pagat dhe mëditjet	20,637,306.00	20,695,556.48	20,582,471.82	19,985,962.75	19,495,068.46
Mallrat dhe shërbimet	7,293,218.00	8,582,131.03	7,438,923.02	5,678,409.41	5,609,365.20
Komunalit	998,199.00	936,212.88	680,450.02	808,493.01	763,463.80
Subvencionet dhe transferet	900,000.00	1,989,036.52	1,877,049.65	701,262.74	539,905.93
Investimet Kapitale	18,806,278.00	21,451,701.09	14,387,609.02	15,642,243.55	15,341,961.60
Rezervat	2,266,460.00	0.00	0.00	0.00	0.00

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:


- Buxheti fillestar me buxhetin final të kategoritë paga dhe mëditje, si dhe komunalit nuk kishte ndonjë ndryshim të madh;
- Buxheti final në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ishte rritur për 1,288,913€, përkundër kësaj rritje vetëm 87% e buxhetit ishte shpenzuar;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur 1,089,037€, përdërisa realizimi ishte në masën 94% e buxhetit final;
- Buxheti final në kategorinë e investimeve kapitale në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 2,645,423€, përkundër kësaj rritje vetëm 67% e buxhetit ishte shpenzuar. Po ashtu, edhe dinamika e realizimit nuk është në harmoni me planifikimet sepse 51% e shpenzimeve nga kjo kategori janë realizuar në tremujorin e fund vitit. Gjithashtu, vlen të theksohet se nga 88 kontratat e nënshkruara gjatë vitit 2020 në vlerë prej 15,094,586€, vetëm në periudhën e fund vitit janë lidhur 51% kontratave apo 45 kontrata në vlerë 4,303,016€. Kjo një arsye shtesë/tjetër për mos realizim të buxhetit dhe sfidë që duhet të adresohet nga menaxhmenti. Shkaku i një dukurie të tillë sipas menaxherit të prokurimit ishte vonesa në hartimin e projekteve ekzekutive të përcaktuar paraprakisht si kriter ligjor para inicimit të procedurave të prokurimit.

Si rezultat i situatës pandemike me COVID–19, Komuna e Prizrenit kishte shpenzuar 2,021,615€, prej të cilave 842,993€ janë paguar për paga dhe mëditje, 117,422€ për mallra dhe shërbime dhe 1,061,200€ për subvencione.

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Komuna kishte realizuar të hyra në vlerë prej 5,971,583€, krahasuar me vitin paraprak të hyrat ishin më të ulëta për 988,574€, dhe për këtë kishte ndikuar pandemia me virusin Covid 19. Përveç këtyre, komuna ka pasur edhe të hyra indirekte të cilat mbliidhen nga niveli qendror (gjobat në trafik, të gjykatave si dhe nga agjencia e pyjeve) në vlerë prej 930,143€. Të hyrat tjera prej 485€ janë si e hyrë e bartur nga viti 2019.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Totali i të hyrave	7,560,295.00	7,560,295.00	5,971,583.19	6,960,156.76	6,307,457.52
Të hyrat tatimore	2,848,910.00	2,848,910.00	2,205,371.85	2,394,259.23	2,196,722.46
Të hyrat jo tatimore	4,711,385.00	4,711,385.00	3,765,726.34	4,558,418.93	4,110,735.06
Të hyrat tjera	0.00	0.00	485.00	7,478.60	

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2019 të Komunës së Prizrenit ka rezultuar në 23 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Komuna e Prizrenit ka hartuar Raportet periodike për ecurinë e rekomandimeve të ZKA për vitin 2019 dhe atë me datat 30.09.2020 si dhe 15.03.2021.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, 11 rekomandime janë zbatuar, një ishte në proces të zbatimit, 10 rekomandime nuk janë zbatuar ende si dhe një nuk është i aplikueshëm, siç është paraqitur në Grafikon 4, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr.	Fusha Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet ndërmarra	Statusi
1.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që kërkesat të planifikohen dhe kategorizohen sipas ndarjes adekuate të buxhetit. Nëse projeksionet e buxhetuara me ligj të buxhetit nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe nevojat e komunës, duhet të bëhet ridestinimi i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve. Kjo duhet të reflektoj në përpjekjen për buxhetimin e kërkesave në kategoritë përkatëse ekonomike dhe fuqizimin e kontrollit për pagesën, evidentimin dhe prezantimin e drejt të shpenzimeve publike në PFV.	Kjo çështje do të trajtohet në Raportin vjetor të auditimit RVA.	Nuk është aplikueshëm më
2.	Të hyrat	Kryetari duhet të vendos kontrolle duke caktuar zyrtar përgjegjës që përcjelljen ndryshimin/plotësimin e rregullave/ligjeve të nivelit qendror, dhe që të njëjtat përditësime të cilat kanë ndikim në rregulloret e brendshme komunale, duhet me kohë të iniciohen për ndryshim duke i përcjellë për miratim tek organet relevante dhe monitorohet zbatueshmëria e tyre.	Janë marrë veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi.	I zbatuar
3.	Të hyrat	Kryetari duhet të shtoj kontrollet në mënyrë që të gjitha Lejet Ndërtimore lëshohen sipas kërkesave ligjore dhe të hyrat inkasohen në kohën e duhur.	Janë marrë veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi.	I zbatuar
4.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj bashkëpunim dhe komunikim më të mirë në mes të Departamentit të Tatimit në Pronë Komunal dhe Ministrisë së Financave, në mënyrë që të eliminohen gabimet e mundshme në bazën për tatimin e vlerësuar, apo ndonjë gabimi tjetër eventual.	Nuk janë marrë veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë se do të kryhen analiza të mirëfillta nga menaxhimi i mbeturinave në mënyrë që të arrihen objektivat e komunës në krijimin e sistemit të qëndrueshëm financiar. Po ashtu, të merret në konsideratë që paraprakisht të rifreskohet data baza e ngarkesave si dhe të bëhen ndryshimet dhe aprovimet në rregullore nga organi legjislativ për lirin apo përcaktimin e tarifa për amvisëritë e caktuara.	Edhe këtë vit kemi faturime në kundërshtim me rregulloren e fuqi.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj marrjen e masave për largimin e shfrytëzuesve ilegal nga pronat publike, arkëtimin e	Nuk janë marrë veprimet e nevojshme për	Nuk ka filluar zbatimin

		borxheve dhe më pastaj dhënia e pronës publike me qira të realizohet sipas Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale 06/L-092.	zbatim të këtij rekomandimi.	
7.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari të sigurohet se drejtorët e institucioneve shëndetësore dhe menaxheri i personelit duhet të kompletojnë dëshmitë për përvojën e punës për të krijuar bazë ligjore për ekzekutimin e shtesës në bazë të përvojës.	Gjatë testimeve kemi se dosjet kanë qenë të kompletuara me dëshminë e përvojës se punës.	I zbatuar
8.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalit	Kryetari duhet të sigurojë se marrëveshjet për shërbime të veçanta të planifikohen drejt dhe angazhimet për këto shërbime të mos zgjasin më shumë se afati i paraparë ligjorë. Po ashtu kryetari duhet të sigurojë se punonjësit me kontrata për shërbime të veçanta do të angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike.	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur parregullsi të tilla.	I zbatuar
9.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalit	Kryetari i Komunës të siguroj që komisionet për pranimin e mallrave/shërbimeve të vendosura si pika të kontrollit, e shqyrtojnë paraprakisht të gjithë dokumentacionin dhe sigurohen se mallrat/shërbimet janë pranuar para se të lejohen urdhër pagesat. Në të kundërtën duhet të zbatohen masat për lëshimet e identifikuar dhe papërgjegjësive të komisioneve.	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur parregullsi të tilla.	I zbatuar
10.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalit	Kryetari i komunës të siguroj që janë vlerësuar nevojat e tërësishme të komunës për furnizime, shërbime të ngjashme dhe të lidh kontratë të përbashkët më qëllim të kontraktimit me çmime më të favorshëm për komunën dhe sigurimin e cilësisë më të lartë të furnizimit.	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur parregullsi të tilla.	I zbatuar
11.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalit	Kryetari të siguroj që menaxheri i prokurimit nuk nënshkruan kontrata pa siguruar se janë plotësuar dhe kushtet e pranueshmërisë së tenderëve.	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur parregullsi të tilla.	I zbatuar
12.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të siguroj që ka transparencë në procedura dhe vendimmarrje në gjithë ciklin e ofrimit të mbështetjes financiare, duke përfshirë publikimin e kriteve dhe procedurave, aplikimin, vendimmarrjen dhe përzgjedhjen e përfituesve. Çdo ofrues i mbështetjes financiare (komuna) që planifikon mbështetje financiare për OJQ-të duhet të disponojnë me kapacitete institucionale, duke përfshirë burimet e nevojshme njerëzore për të zbatuar kërkesat ligjore. Komisioni Vlerësues të përbëhet nga anëtarë që kanë përvojë dhe integritet, me mandat për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve, në të	Kriteret për thirrjen publike për subvencionimin e OJQ janë zbatuar, ndërsa ne vlerësimin e aplikueshëm me rastin e përzgjedhjes së përfituesve nuk janë aplikuar kriteret.	Pjesërisht i zbatuar

		kundërtën duhet të zbatohet parimi i llogaridhënies për shfrytëzimin e këtyre fondeve.		
13.	Investimet kapitale	Kryetari përmes menaxherëve të kontratave duhet të sigurohet që fillimisht të mos lejoj ndryshime-tejkalime të pozicioneve të paramasave të kontraktuara, dhe nëse paraqitet nevoja për ndryshime të raportohet për çdo devijim nga termat dhe kushtet e kontratës. Po ashtu, çdo ndryshim në kushtet e kontratës duhet të arsyetohet në detaje nga menaxheri i projektit, përgatitet nga prokurimi dhe aprovohet nga nivelet relevante.	Janë marrë veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandim.	I zbatuar
14.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që për të gjitha shpenzimet paraprakisht personat përgjegjës ushtrojnë kontrollet adekuate, në mënyrë që të bëjnë barazimet e nevojshme para realizimit të pagesave.	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur parregullsi të tilla.	I zbatuar
15.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që hartimi i projekteve ekzekutive të realizohet në pajtim me kërkesat ligjore, gjegjësisht hartimin e tyre para inicimit të procedurave të prokurimit	Nuk janë marrë veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin
16.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që para nënshkrimit të kontratave të bëhet zotimi i mjeteve në mënyrë që të eliminohet praktika e pranimit të mallit dhe punëve pa zotim të mjeteve.	Nuk janë marrë veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin
17.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë përmes zyrtarëve përgjegjës, që çdo projekt të realizohet brenda kornizës kohore të përcaktuar në kontrata dhe se sigurimi i ekzekutimit duhet të ketë vlefshmëri në raport me periudhën e përbushjes së kontratës ashtu siç parashihet në ligj.	Nuk janë marrë veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin
18.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që paraprakisht të eliminohen shkaqet e vonesave, të sigurohen fondet e nevojshme, planifikimi i mirëfilltë si dhe të forcohen kontrollet në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve në mënyrë që ato të përfundohen me kohë sipas planit dinamik. Aty ku është e nevojshme, të zbatohen masat ndëshkuese sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.	Nuk janë marrë veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin
19.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë që kërkesat në lidhje me regjistrimin dhe mirëmbajtjen e pasurive duhet të aplikohen në tërësi, ku përmes sistemit e-pasuria evidentohen të gjitha hyrjet/daljet e pasurive të luajtshme (me vlera nën 1,000€) për të gjitha dikasteret komunale. Po ashtu, duhet të sigurojë që raportet e komisionit të inventarizimit dhe ai i vlerësimit të finalizuar, harmonizohen me gjendjen e pasurisë në regjistra dhe i paraprijnë	Nuk janë marrë veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin

		përgatitjes së PFV, në mënyrë që vlera e pasurisë të prezantohet saktë.		
20.	Llogaritë arkëtueshme	e Kryetari duhet të sigurojë që llogaritë e arkëtueshme të shpallura në PFV të harmonizohen me raportet financiare për të hyrat nga mbeturinat të verifikuar paraprakisht për plotësinë dhe saktësinë e tyre. Të shqyrtoj në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme në pajtim me ligjin, ndaj debitorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.	Janë marrë veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi.	I zbatuar
21.	Obligimet papaguara	e Kryetari duhet të sigurojë që detyrimet kontingjente janë prezantuar drejtë në PFV. Duhet të sigurohen të dhënat e sakta dhe të plotat mbi këto detyrime nga zyra ligjore dhe të njëjtat të përcillen në zyrën e financave si hartuese të PFV.	Nuk janë marrë veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin
22.	Obligimet papaguara	e Kryetari të sigurojë që prezantohen saktë në shpallje vetëm obligimet të cilat kanë raport të përfundimit të punëve/shërbimeve apo furnizimeve para lëshimit të faturës, duke siguruar që të prezantohen drejtë ato.	Janë marrë veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi	I zbatuar
23.	Obligimet papaguara	e Kryetari duhet të sigurojë që obligimet të planifikohen/buxhetoren dhe paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i komunës me kosto shtesë të përmburimit.	Nuk janë marrë veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin

Nr.	Fusha Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të formojë një komision profesional i cili do të verifikoj faturat e fshira/anuluara për tu siguruar se faturat e fshira/anuluara vërtet kanë qenë gabim bazuar në gjendjen faktike. Po ashtu, duhet të sigurojë se ankesat pranohen përmes zyrës së protokollit dhe se shqyrtimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.
2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë bashkëpunim dhe komunikim më të mirë në mes të Departamentit të Tatimit në Pronë Komunal dhe Ministrisë së Financave, në mënyrë që të eliminohen gabimet e mundshme në bazën për tatimin e vlerësuar, apo ndonjë gabimi tjetër eventuale.
3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se do të kryhen analiza të mirëfillta nga menaxhimi i mbeturinave në mënyrë që të arrihen objektivat e komunës në krijimin e sistemit të qëndrueshëm financiar. Po ashtu, të merret në konsideratë që paraprakisht të rifreskohet data baza e ngarkesave si dhe të bëhen ndryshimet dhe aprovimet në rregullore nga organi legjislativ për lirin apo përcaktimin e tarifa për amvisëritë e caktuara.
4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që detyrimet kontingjente janë prezantuar drejtë në PFV. Duhet të sigurohen të dhënat e sakta dhe të plotat mbi këto detyrime nga zyra ligjore dhe të njëjtat të përcillen në zyrën e financave si hartuese të PFV.
5.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë marrjen e masave për largimin e shfrytëzuesve ilegal nga pronat publike, arkëtimin e borxheve dhe më pastaj dhënia e pronës publike me qira të realizohet sipas Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale 06/L-092.
6.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë përmes menaxherit të personelit se zhvillimi i procedurave të rekrutimit bëhet në pajtim të plotë me kërkesat ligjore, dhe në rast të mungesës së tre kandidatëve të përgjegjshëm të rishpallet konkursi.

7.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të siguroj që të gjithë të punësuarit paguhen në bazë të pozitave zyrtare që janë të emëruar dhe të sigurojë harmonizimin e akt emërimeve me listën e pagave për të gjithë të punësuarit.
8.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalit	Kryetari duhet të siguroj aplikimin e procedurave të duhura të prokurimit duke rritur konkurrencën në mënyrë që kontraktimi i mallrave/furnizimeve të bëhet me çmime dhe cilësi komfor kushteve të tregut.
9.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të siguroj që ka transparencë në procedura dhe vendimmarrje në gjithë ciklin e ofrimit të mbështetjes financiare, duke përfshirë publikimin e kriterëve dhe procedurave, aplikimin, vendimmarrjen dhe përzgjedhjen e përfituesve. Çdo ofrues i mbështetjes financiare (komuna) që planifikon mbështetje financiare për OJQ-të duhet të disponojnë me kapacitete institucionale, duke përfshirë burimet e nevojshme njerëzore për të zbatuar kërkesat ligjore. Komisioni Vlerësues të përbëhet nga anëtarë që kanë përvojë dhe integritet, me mandat për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve, në të kundërtën duhet të zbatohet parimi i llogaridhënies për shfrytëzimin e këtyre fondeve.
10.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që hartimi i projekteve ekzekutive të realizohet në pajtim me kërkesat ligjore, gjegjësisht hartimin e tyre para inicimit të procedurave të prokurimit
11.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj që para nënshkrimit të kontratave të bëhet zotimi i mjeteve në mënyrë që të eliminohet praktika e pranimit të mallit dhe punëve pa zotim të mjeteve.
12.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj përmes zyrtarëve përgjegjës, që çdo projekt të realizohet brenda kornizës kohore të përcaktuar në kontrata dhe se sigurimi i ekzekutimit duhet të ketë vlefshmëri në raport me periudhën e përmbushjes së kontratës ashtu siç parashihet në ligj.
13.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj që paraprakisht të eliminohen shkaqet e vonesave, të sigurohen fondet e nevojshme, planifikimi i mirëfilltë si dhe të forcohen kontrollet në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve në mënyrë që ato të përfundohen me kohë sipas planit dinamik. Aty ku është e nevojshme, të zbatohen masat ndëshkuese sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.
14.	Pasuritë	Kryetari duhet të siguroj që kërkesat në lidhje me regjistrimin dhe mirëmbajtjen e pasurive duhet të aplikohen në tërësi, ku përmes sistemit e-pasuria evidentohen të gjitha hyrjet/daljet e pasurive të luajtshme (me vlera nën 1,000€) për të gjitha dikasteret komunale. Po ashtu, duhet të siguroj që raportet e komisionit të inventarizimit dhe ai i vlerësimit të finalizuar, harmonizohen me gjendjen e pasurisë në regjistra dhe i paraprijnë përgatitjes së PFV, në mënyrë që vlera e pasurisë të prezantohet saktë.
15.	Obligimet papaguara	Kryetari duhet të sigurojë që obligimet të planifikohen/buxhetoren dhe paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i komunës me kosto shtesë të përmbarimit.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm




Arian Haxha, Udhëheqës i Auditimit



Kapllan Muhaxheri, Udhëheqës i ekipit



Mehmet Kurti, Anëtar i ekipit



Hysen Boqolli, Anëtar i ekipit



Florim Maliqi, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Kosova Cumhuriyeti



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës • Председник Општине
Belediye Başkanı

01 Nr. 261121 Dt. 22.07.2021



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren
Prizren Belediyesi

DATE:	22.07.2021
REFERENCE:	01/261121
PËR:	Zyrën Kombëtare të Auditimit
LËNDA/TEMA	LETËR E KONFIRMIMIT Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Prizrenit, për vitin 2020 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- **pajtohem/** nuk pajtohem/ pajtohem pjesërisht/ me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Prof. Dr. Mytahir Haskuka
Kryetar i Komunës,

Data: Korrik, 2021, Prizren



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare¹⁰ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.¹¹ Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinionin mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200
)

Forma e opinionit

Opinionin i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(ve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- 1 Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- 2 Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- 3 Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- 4 Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- 5 Kontrata për “Furnizim me pako ushqimore për rastet e vet izoluar dhe rastet sociale në Komunën e Prizrenit” në vlerë 32,990€. Realizimi i platformës digjitale për nevojat e arsimit në Prizren në vlerë të kontratës 116,614€
Furnizim më PCR rapid teste ne vlere te kontratës 118,845€ dhe Furnizim më reagenca për analizën D- Dimer ne vlerë të kontratës 35,997€
- 6 [*]1. Pagesa në shumë 79,916€ mirëmbajtje investive,2. Pagesa 100,000€ mirëmbajtje investive,3. Pagesa në shumë 86,294€ mirëmbajtje investive 4. Pagesa ndërtimi i rrugëve në shumë 55,000€, 5. Pagesa për ndërtimin e rrugëve 50,000€, 6. Pagesa prej 7,998€ në emër të mirëmbajtës, 7. Pagesa për hartimin e projekteve ne shume 24,579€ dhe 8. Pagesa në shumë 125,604€ për mirëmbajtje investive.
- 7 [*]Te kontrata “ Ndërtimi i stadiumit ne Zhur” 692,259€ ndonëse nuk është kryer sipas afatit te parapare nuk ishte kërkuar nga zyra e prokurimit ripërtëritja e sigurimit te ekzekutimit si dhe kontrata’ 'Ndërtimi i infrastrukturës rrugore ne fshatin Gjonaj”217,113€
- 8 [*] 1. Titulli i projektit: Mirëmbajtja e rrugëve lokale te ndërtuara me elemente betoni, gurë, mermeri dhe ndërtimi i trotuareve, vlere e kontratës, 1,494,600€, dt. e nënshkrimit të kontratës 14.09.2017, plani dinamik 360 ditë pune, afati për përfundimin e punëve 20.09.2020, ende e papërfunduar; 2. Titulli i projektit “ Ndërtimi i shtegut te atletikes ne Prizren, vlere e kontratës 366,144€ dt. e nënshkrimit të kontratës 03.12.2018 , plani dinamik, 15 muaj kalendarik, afati për përfundimin e punëve 03.02.2020, vonesa projekti ende i pa përfunduar.
- 9 Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- 10 Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- 11 Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.